



Data	
Nr. Prot	

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË SHKODËR, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E “PARTISË DEMOKRATIKE TË
SHQIPËRISË”, Z. FATMIR GJON VOJVODA**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Me shkresën nr. 2320 prot., datë 02.02.2024, Këshilli i Bashkisë Shkodër ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Gjovalin Gjergj Darragjati, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Demokratike të Shqipërisë, për Këshillin e Bashkisë Shkodër, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 7, z. Fatmir Gjon Vojvoda.

Me shkresën nr. 466, prot., datë 19.2.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Shkodër, z. Fatmir Gjon Vojvoda, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit Partia Demokratike e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër SHK-PDSH-8149_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Fatmir Gjon Vojvoda., rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 me shkresën nr. 553 prot., datë 26.02.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 551 prot., datë 26.02.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për z. Fatmir Gjon Vojvoda.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr.2452/1 prot., datë 6.3.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar z. Fatmir Gjon Vojvoda, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 3084/1 prot., datë 4.3.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Fatmir Gjon Vojvoda, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Fatmir Gjon Vojvoda në Këshillin e Bashkisë Shkodër, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

Jona JOSIFI - Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit

Majlinda ÇELMETA - Drejtorja e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

Ylli MERKAJ - Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË SHKODËR, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E “PARTISË DEMOKRATIKE TË
SHQIPËRISË”, Z. FATMIR GJON VOJVODA**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 2320 prot., datë 02.02.2024, Këshilli i Bashkisë Shkodër ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Gjovalin Gjergj Darragjati, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Demokratike të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Shkodër, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 7, z. Fatmir Gjon Vojvoda.

Me shkresën nr. 466, prot., datë 19.2.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Shkodër, z. Fatmir Gjon Vojvoda, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456
Ora: hh:mm



“Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Shkodër me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Demokratike të Shqipërisë zj. Fatmir Gjon Vojvoda”

pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit Partia Demokratike e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër SHK-PDSH-8149_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Fatmir Gjon Vojvoda, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit me shkresën nr. 553 prot., datë 26.02.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 551 prot., datë 26.02.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për z. Fatmir Gjon Vojvoda.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 2452/1 prot., datë 6.3.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar z. Fatmir Gjon Vojvoda, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 3084/1 prot., datë 4.3.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Fatmir Gjon Vojvoda, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Fatmir Gjon Vojvoda në Këshillin e Bashkisë Shkodër, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Shkodër, me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Demokratike të Shqipërisë, z. Fatmir Gjon Vojvoda.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI